

SHOQERIA "T & XH" SH.P.K.

NUIS : L72121504I

Adresa: Rr. Stavër Th. Frashëri, Apartamenti Nr. 8138, Lagjja 17, Durrës

**VENDIM NR 03, DATE 09.10.2019
I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE TREGTARE
" T & XH " SH.P.K. DURRES**

Ne Durrës, sot ne date 09, muaji Tetor, viti 2019, u mbledh Ortaku i vetem i Shoqerise Tregtare "T & XH " Sh.p.k. Durrës , ne seline e saj dhe mori ne shqyrtim rendin e dites :

- a) Zmadhimin e kapitalit aksionar te Shoqerise Tregtare " T & XH " Sh.p.k. Durrës.

Ortaku i Vetem ,z. Përparim CENA, pasi u njoh me rendin e dites

VEREN SE :

Shoqeria Tregtare " T & XH " Sh.p.k. Durrës, eshte themeluar me date 15.09.2017 dhe eshte rregjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit, date 21.09.2017, me ortak te vetem dhe administrator z. Përparim CENA.

Gjate shqyrtimit te veprimtarise tregtare dhe tregueseve financiare te shoqerise " T & XH " Sh.p.k. Durrës, Ortaku i Vetem konstaton se per per te patur nje vazhdimesi dhe siguri te veprimtarise, gjendjen e fitimeve dhe e rezervave te pa shperndara me 31 Dhjetor 2018 ti kaloje: 1) per zmadhim te kapitalit aksionar te kesaj shoqerie me vleren 4,999,000 Leke, 2) dhe diferenca qe ngelet pasi eshte mbuluar humbja e mbartur te kaloj per rezerva ligjore 500,000 leke dhe ne rezerva te tjera 90,748 leke , ne baze te Statutit, Aktit te Themelimit dhe Ligjit "Per tregtetaret dhe shoqerite tregtare" .

Per keto arsye,Ortaku i Vetem i Shoqerise Tregtare " T & XH " Sh.p.k. Durrës z. Përparim CENA, pas shqyrtimit te rendit te dites :

VENDOSI :

- Kalimin e fitimeve dhe rezervave te te pashperndara gjendje sipas bilancit te mbyllur me 31 Dhjetor 2018 per: 1) zmadhimin e kapitalit aksionar te shoqerise me vleren 4,999,000 leke, 2) shtim te rezervës ligjore me 500,000 leke , dhe 3) diferenca prej 90,748 leke te mbetet per rezerva te tjera ;
- Caktimin e z. Lavdimir FUSHA, anetar i Insitutit te Eksperteve Kontabel te Regjistruar, me Nr.Licence 97 date 10.01.2001, per vleresimin e zmadhimit te kapitalit aksionar me fitimet dhe rezervat e pa shperndara , gjendje sipas bilancit te mbyllur me 31 Dhjetor 2018 ;
- Depozitimim e ketij vendimi prane Qendres Kombetare te Biznesit , si dhe Drejtorise Rajonale Tatimore Durrës.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE TREGTARE

" T & XH " SH.P.K DURRES

PËRPARIM CENA



SHOQERIA "T & XH" SH.P.K.

NUIS : L72121504I

Adresa: Rr. Stavër Th. Frashëri, Apartamenti Nr. 8138, Lagjja 17, Durrës

**VENDIM NR 04, DATE 17.10.2019
I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE TREGTARE
" T & XH " SH.P.K. DURRES**

Në Durrës, sot në datën 17, muaji Tetor, 2019, u mbledh Ortaku i Vetëm i Shoqërisë Tregtare " T & XH " SHPK Durrës, në selinë e shoqërisë, për shqyrtimin e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar për vlerësimin e fitimeve dhe rezervave të pashpërndara për zmadhimin e kapitalit aksionar të Shoqërisë, të datës 16 Tetor 2019 të përgatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabël i Regjistruar;

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, z. Perparim CENA , pasi u njoh me rendin e ditës;

V Ë R E N S E

Shoqëria Tregtare " T & XH " Sh.p.k. Durrës, është themeluar me date 15.09.2017 dhe është regjistruar pranë Qendres Kombetare të Biznesit, date 21.09.2017, me ortak të vetem dhe administrator z. Perparim CENA.

Ortaku i Vetëm i kësaj shoqërie është z. Perparim CENA. Kapitali aksionar i kësaj shoqërie është 1,000 (Nje mije) Lekë. Kështu, z. Perparim CENA zotëron 100 % të kapitalit aksionar, i barabartë ky me 1 (një) kuota me vlerën 1,000 (Nje mije) Lekë, ku secila kuotë ka vlerën prej 1,000 (Nje mije) Lekë;

Me Vendimin Nr. 03, datë 09.10.2019, Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ka vendosur:

- Kalimin e fitimeve dhe rezervave të pashpërndara gjendje sipas bilancit të mbyllur me 31 Dhjetor 2018 per: 1) zmadhimin e kapitalit aksionar të shoqërisë me vlerën 4,999,000 leke, 2) shtim të rezervës ligjore me 500,000 leke , dhe 3) diferenca prej 90,748 leke të mbetet për rezerva të tjera ;
- Caktimin e z. Lavdimir FUSHA, anetar i Insitutit të Eksperteve Kontabel të Regjistruar, me Nr.Licence 97 date 10.01.2001, për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit aksionar me fitimet dhe rezervat e pa shpërndara , gjendje sipas bilancit të mbyllur me 31 Dhjetor 2018 ;
- Depozitimin e këtij vendimi pranë Qendres Kombetare të Biznesit , si dhe Drejtorise Rajonale Tatimore Durrës.

Në vështrim të rendit të ditës, Ortaku i Vetëm i kësaj shoqërie, pasi njihet me Raportin e Ekspertit Kontabël të Regjistruar për vlerësimin e fitimeve dhe rezervave të pashpërndara për zmadhimin e kapitalit aksionar të Shoqërisë, të datës 16 Tetor 2019, i përgatitur nga Eksperti Kontabël i Regjistruar z. Lavdimir FUSHA, vëren se ky raport është i drejtë, në përputhje me ligjet në fuqi dhe për këto arsye duhet miratuar.

Sipas këtij raporti, zmadhimi i kapitalit aksionar të shoqërisë bëhet nga 1,000 (Nje mije) Leke në 5,000,000 (Pese milion) Leke, e barabartë kjo me 1 (Nje) kuota (pjesë) kapitali, secila me vlerë



nominale prej 5,000,000 (Pese milion) Lekë. Pra, numri i kuotave (pjesëve) të kapitalit aksionar mbetet i pandryshueshëm dhe vetëm vlera nominale e tyre rritet.

Ky kapital do të zotërohet nga Ortaku i Vetëm në këtë mënyrë:

z. Përparim CENA, do të jetë përsëri zotërues i 100 % të kuotave të kapitalit aksionar, i cili do të përbëhet nga 1 (nje) kuota (pjesë) kapitali nga ku secila kuotë (pjesë) do të ketë vlerën nominale prej 5,000,000 (Pese milion) Lekë.

Për këto arsye, Ortaku i Vetëm, pas shqyrtimit të rendit të ditës;

V E N D O S I

1. Miratimin e Raportit të Ekspertit për vlerësimin e fitimeve të pashperndara për zmadhimin e Kapitalit Aksionar të Shoqërisë të datës 16 Tetor 2019 të përgatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabel i Regjistruar;
2. Zmadhimin e Kapitalit Aksionar të kësaj shoqërie nga 1,000 (Nje mijë) Leke në 5,000,000 (Pese milion) Leke, e barabarte kjo me 1 (Nje) kuota (pjesë) kapitali;
3. Numri i kuotave (pjesëve) të kapitalit, mbetet i pandryshueshëm, dhe rritet vetëm vlera nominale e tyre;
4. Vlera e çdo kuote (pjesë) kapitali kalon nga 1,000 (Nje mijë) Leke në 5,000,000 (Pese milion) Leke ;
5. **z. Përparim CENA**, do të jetë përsëri zotërues i 100 % të kuotave të kapitalit aksionar, i cili do të përbëhet nga 1 (Nje) kuota (pjesë) kapitali ku secila kuotë (pjesë) do të ketë vlerën nominale prej 5,000,000 (Pese milion) Leke ;
6. Depozitimim të këtij vendimi pranë Qendres Kombetare të Biznesit .

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË TREGTARE

" T & XH " SHPK DURRES

PËRPARIM CENA

